



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gashi 3 ing" Sh.P.K. të datës 15.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 10.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës që lidhë rrugën 1 tetori me rrugën Isa Kastrati" me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gashi 3 ing" Sh.P.K. e datës 15.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 10.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës që lidhë rrugën 1 tetori me rrugën Isa Kastrati" me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 10.01.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Gashi 3 ing" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Gashi 3 ing" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 15.01.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës që lidhë rrugën 1 tetori me rrugën Isa Kastrati" me nr. të prokurimit 616-23-12047-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

#### **Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

1. *"Marreveshja per themelimin e grupit i mungojne marreveshje e veqanta te anetareve qe kane themeluar grupin"*.
2. *"Plani dinamik eshte i nenshkruar vetem nga njeri anetar"*.
3. *"Vendimi per project menagjer i nenshkruar vetem nga njeri anetar i grupit"*.
4. *"Marreveshjet per furnizim me beton vetem nga njeri anetar i konzorciumt"*.
5. *"Marreveshjet per furnizim me zhavor dhe Asfalt te nenshkruara vetem nga njeri anetar i konzorciumit"*.
6. *"Inxh.Afrim Proksli(inxh i Elektr-Termontimi) ka kontrate valide deri me 31/12/2023-ndersa ne dosje te tenderit eshte kerkuar kontarte te perhershme pa afat te caktuar qe dmth se kontrata e tij nuk ka validitet me validitetin e ofertes"*
7. *"Inxh Avni Derguti ka nenshkruar kontrate me Termontimin me date 25/05/2023 –ku neni 6 I kontrates specifikon te njejtin se eshte i angazhuar ne periudhe provuese per 3 muaj qka nenkupton qe pas 3 muaj duhet kontrate e re sepse kalon periudha provuese"*.
8. *"Kontratat me punetor per termontimin shumicen i ka nenshkruar Blond Mecinaj i cili eshte i punesuar ne Termomontim dhe njejtin nuk te drejte ligjore si punemarres njeher me Termomontimin ,heren tjeter te jete ne cilesin e punedhenesit qe eshte ne kundershtrim me Ligjin mbi the,elimin e marredhenjies se punes"*.
9. *"Inxh Xhavit Jasiqi ke te nenshkruar kontrate valide me Termontimin por kontraten ne emer te Termontimit e ka nenshkruar Avni Derguti i cili eshte ne maredhnie pune me Termontimi ne baze te kontrates te nenshkruar nga i njejtin ne cilesin e punemarresit dhe z,Skender Mecinaj si punedhenes ,prandaj ne kontarten me inxh Xhavit Jasiqin nenshkrimi i tij si punedhenes eshte ne kundershtrim te plote me ligjin mbi themelimin e marredhenies se punes"*.
10. *"Kontrata me Gani Musliun IDM-Makinerise e lidhu rme date 24/05/2023 ,poashtu ne baze te nenit 4 te kontrates I nenshtrohet periudhes provuese prej 3 muaj qka nenlupton qe pas kesaj date duhej firmosur kontrate e re ,per te provuar se I njejtin ka kaluar me sukse kete periudhe testuese"*.
11. *"Ne kompanin Termomontimi jane tre persona qe kane nenshkruar dokumente qe lidhen me kete Aktivitet te prokurimit :Skender Mecinaj - i cili edhe ne baze te qart se biznesit prane ARBK se eshte pronar legjitim ndersa Bliond Mecinaj dhe Avni Derguti edhe ne baze te listes se ATK shihet se jane te punesuar ne Termomontim dhe qdo document i nenshkruar nga keta te dy (ne cilesin e punedhensit jane jovalide)"*.
12. *"Inxh Sali Fazliu –IDN-Hidroteknik –ne baze te deklarates se dhene vetem nga njeri anetar i konzorciumit REXHA shpk –duhet te jene aktiv ter ekohen ne kete project i njejtin ka marredhenjie pune te perhershme me nje institucion tjeter dhe prezenca e tij aktive ne kete project ka shume paqartesi dhe nenshkrimi i deponuar ne marreveshjen e prezentuar nuk eshte nenshkrimi i zakonshem i personit ne fjale"*.

13. "Menagjer I projektit eshte caktuar z.Hilmi Mulaku –edhe kjo deklarate eshte e nenshkruar nga vetem njeri anetar I konzorciumit .Per z.Hilmi Mulaku esht eprezentuar nje kontrate me Rexha shpk e dates 07/01/2015 ku ne baze te nenit 6 te kesaj marreveshje kontrata lidhet me afat te caktuar duke potencuar vetem daten e lidhjes se kontrates –e cila ne rastet kur eshte e caktuar maximum i validitetit eshte deri ne fundin e vitit kalendarik. Ne baze te referencave te prezentuara nga Rexha shpk te dates 22/12/2029, qarte potencohet se i njejti ka punuar ne kete kompani nga viti 2015 deri ne vitin 2019,qka nenkuptohet ne baze te ketij dokumenti se i njejti nuk punon ne kete kompani. Te gjitha noterizimet e inxh te tjere kane data me te aferta ,nders anoterizimi i diplomes se z.Hilmi Mulaku mban daten 01/10/2018, qka korrespondon me refrencen e leshuar dhe ngrite dyshime se I njejti me nuk punon ne kete kompani dhe nuk mundet me qene Menaxher I Projektit .Edhe ne listen e Stafit te prezentuar per Inxh e Angazhuar ne kete project mungon marreveshja per Angazhim me z,Mulaku. Ne baze te kesaj ky GOE ka deshtuar te permbush kriterin ne FDT 9.1& 9.2 pika A".
14. "Inxh I Gjeodezise z,Milaim Sylka eshte I prezentuar ne Listen e stafit te Inxhinjereve te propozuar per kete kontrate ,nuk ka marreveshje angazhimi per kete project ,ka nje kontrate jo valide ne baze te nenit 6 e themeluar me kohe te caktuar nga data 07-01/2015 me mundesi vazhdimi ,pa cekuar kohën e skadences ,por ne baze te ligjit mbi themelimin e marredhenjies se punes jane te ditura afatet kohore per kontratat me afat te caktuar ,qka nenkupton se kontrata e tij eshte jovalide dhe ky GOE ka deshtuar te permbush kriterin e FDT 9.1 & 9.2 tek pika D inxh. i dipl. i gjeodezise".
15. "Sipas FDT te 9,1 & 9.2 pika G....1 (Nje) Teknik –Drejtimi i Ndertimtarise ky GOE ka prezentuar z,Korab Qadraku i cili ne baze te dokumentacionit te prezentuar eshte Bachelor i Ndertimtarise dhe nuk permbush kriterin ne fjale sepse AK ne menyre te qarte ka kerkuar teknik te ndertimtarise me pregaditje shkollore Shkolla e Mesme".
16. "GOE i mungon marreveshja e Huazimit te makinerise me OE Haxha Com dhe prezentimi i makinerise se ketij OE pa marreveshje paraprake nenkupton qe e tere makinerija e tij nuk vlene per kete tender sepse i njejti nuk eshte anetar i grupit pjesmarres ne kete Aktivitet ,prandaj mungojne makinerit se ne vijim: Kater Kamion Veteshkarkues me mbi 10 m3, Finisher per shtruarjen e Asfaltit, 1 (nje) cylinder per asfaltim, Sperkates per bitumen dhe Emulsion".

Lidhur me pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të pretendimeve ankimore, duhet cituar nenin 26 par. 26.1 dhe 26.2 të RRPP ku thuhet se "26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:

- a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;
- b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);
- c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm); dhe

d. Secili anëtar i grupit duhet të jëtë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. (Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP);

26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument”.

Ndërsa përmes nenit 26 paragrafit 26.5 të RRPP përcaktohet që “Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”.

Duke u referuar te dispozitat e cituara si më sipër, rezulton se dokumentet të cilave parashtruesi ju referohet në pikat 1 deri 5 të pretendimeve ankimore nuk ka nevojë që të nënshkruhet individualisht nga secili anëtar i grupit.

Pika nr. 6 e pretendimeve ankimore i referohet kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

**E. Një (1) Inxhinier i**

**Elektroteknikës – Energjetikës.**

**E:**

- **Diplomë universitare e programit master – Kopje e Noterizuar;**
- **CV-në e nënshkruar nga kandidati;**
- **Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;**
- **Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës (ne ekzekutimin e projekteve të rrugëve), min. 5 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet me te paktën nje kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara;**

Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se për pozitën e inxhinierit të elektroteknikës është prezantuar z. Afrim Prokshi. Mirëpo në këtë rast nuk është prezantuar kontrata e përhershme e punës por vetëm kontrata e përkohshme e cila ka skaduar me datë 31.12.2023.

**KONTRATË PUNE  
PËR  
KOHË TË CAKTUAR  
PËR BASHKËPUNTORË PROFESIONAL**

**Neni 1**

Me këtë Kontratë: **"TERMOMONTIMI" SH.P.K. Zona Industriale, Prishtinë, NUMRI UNIK IDENTIFIKUES: 810197104,**

të cilin e përfaqëson: **SKENDER MECINAJ** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me:

**AFRIM PROKSHI, INXH I DIPL. I ELEKTROTEKNIKËS, ID; 1015543279**

(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit (në tekstin e mëtejshëm: I punësuar).

**Neni 2**

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: **INXH I DIPL. I ELEKTROTEKNIKËS – AUDITIMIN E ENERGISË NË NDËRTESA DHE NDRICIM PUBLIK**

(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

**Neni 3**

I punësuar do të kryejë punët në: Punishite të punëdhënësit

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

**Neni 4**

I punësuar themelon marrëdhënie pune, në:

1) kohë të caktuar, duke filluar nga: 04.01.2023, deri më: 31.12.2023.

(data e fillimit dhe mbarimit të punës).

Me mundësi vazhdimi.



Duke marrë parasysh se në dosjen e tenderit është kërkuar specifikisht që "kontrata e punës të jetë e përhershme", rezulton se tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor nr. 6 është i bazuar.

Sa i përket pikës 7 të pretendimeve ankimore, duhet cekur se ajo i referohet kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

2. Lista e it profesional dhe punëtorëve të OE, duhet të jetë minimum 15 punëtor, prej te cileve duhet te jene te profileve si me poshte.

**\*OE duhet te jap nje deklarate poshte listes se stafit se stafi i kerkuar do te jete aktiv gjate implementimitte kontrates.**

2. Liste e punëtorëve(stafit profesional) e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik. Deshmitë e stafit.

**\*Deklarate e nenshkruar dhe vulosur.**

Megjithatë nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se kontrata e punëtorit Avni Dërguti është kontratë për kohë të caktuar e cila si e tillë ka skaduar me datë 31.12.2023.

**KONTRATË PUNËSIMI nr.: 14/23**

E lidhur në mes të:

Punëdhënësit **"TERMOMONTIMI" SHPK** nga Prishtina e përfaqësuar nga **Blond Mecinaj** me Numer Unik Identifikues: **810197104** dhe

Punëtorit **Avni Dërguti** me nr. personal: **2030540177**

**Neni 1**

Punëtori themelon marrëdhënie pune në lemin përkatëse të tij për projektin nga data **07/02/2023** deri me datën **31/12/2023**.

**Neni 2**

Punëtori do ta kryen punen e vet ne vendin afarist të punëdhënësit (ose vendin tjetër) të caktuar nga punëdhënësi. Punëtori do ta kryej punën në poziten si: **Punëtor**

Në anën tjetër në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur edhe lista e punëtorëve edhe deklarata se këta punëtor do të jenë të aktiv gjatë implementimit të kontratës. Prandaj pika 7 e pretendimit ankimor është vetëm pjesërisht e bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 8 dhe nr. 11 është gjetur se pronar të operatorit ekonomik "Termomontimi" janë Skender Mecinaj dhe Fatmir Mecinaj ndërsa drejtor menaxhues i kompanisë është Skender Mecinaj. Në rastin konkret është gjetur se një numër i dokumenteve me të cilat ka ofertuar ky tenderues janë nënshkruar nga z. Blond Mecinaj. Sidoqoftë në ofertë nuk është gjetur asnjë autorizim me shkrim i vërtetuar nga noteri para datës së nënshkrimit të këtyre dokumenteve se z. Blond Mecinaj është autorizuar nga Drejtori Menaxhues që të nënshkruaj dokumente në emër dhe në llogari të operatorit ekonomik "Termomontimi". Megjithatë me rastin e rivlerësimit, komisioni për rivlerësim mund të kërkoj sqarime shtesë nga operatori ekonomik duke kërkuar që të dorëzohet një "Autorizim me shkrim i vërtetuar nga noteri para datës së nënshkrimit të dokumenteve përkatëse, ku drejtori menaxhues i kompanisë e autorizon z. Blond Mecinaj për të nënshkruar dokumentet në fjalë". Rrjedhimisht pretendimi është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 9, duhet cekur se ky pretendim ankimor i referohet kërkesës së dosjes së tenderit të formuluar si në vijim:

**B. Një (1) Inxhinier i  
Ndërtimtarisë – Drejtimi  
Konstruktivë apo fushës së  
ndërtimit të rrugëve**

**B:**

- **Diplomë universitare e programit master (apo 4 vjet e sipër, programi i vjetër në Kosovë) – Kopje e Noterizuar;**
- **CV-në e nënshkruar nga kandidati;**
- **Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;**
- **Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës, min. 5 vite pas diplomimit të dëshmuar me të paktën një kontratë të përfunduar me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara;**

Në rastin konkret nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se për këtë pozitë është propozuar z. Xhavit Jasiqi. Mirëpo kontrata e tij e punës nuk është kontratë e përhershme ashtu sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit por është kontratë me kohë të caktuar e cila do të skadoj me datë 18.05.2024.

**KONTRATË PUNE  
PËR  
KOHË TË CAKTUAR  
PËR BASHKËPUNTORË PROFESIONAL**

**Neni 1**

Me këtë Kontratë: "**TERMOMONTIMI**" SH.P.K, Zona Industriale, Prishtinë, NUMRI UNIK IDENTIFIKUES: 810197104,

të cilin e përfaqëson: **BLOND MECINAJ** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me:

**XHAVIT JASIQI, INXH I DIPL. I NDËRTIMTARISË/KONSTRUKTIV, ID: 1003522489**

(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit (në tekstin e mëtejshëm: I punësuar).

**Neni 2**

I punësuar do të kryej këto detyra të punës: ING. I DIPL. I NDËRTIMTARISË  
(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës).

**Neni 3**

I punësuar do të kryejë punët në: Punishte të punëdhënësit,  
(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme).

**Neni 4**

I punësuar themelon marrëdhënie pune, në:

1) kohë të caktuar, duke filluar nga: 18.05.2023, deri më: 18.05.2024.  
(data e fillimi dhe mbarimit të punës).

Me mundësi vazhdimi.

Fillimisht duhet potencuar se në dosjen e tenderit është kërkuar specifikisht kontrata e përhershme e punës. Duke qenë se në këtë rast është dorëzuar kontrata e punës e përkohshme, tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Ndërsa sa i përket pikës së pretendimit ankimor lidhur me nënshkrimin e punëdhënësit, në hyrje të kontratës thuhet se përfaqësues i punëdhënësit është z. Blond Mecinaj për të cilin është shpjeguar me rastin e shqyrtimit të pretendimeve me numër 8 dhe 11. Mirëpo për më tepër, kontratës i është bashkangjitur edhe një vërtetim noterial ku thuhet se kontratën e ka nënshkruar z. Avni Durguti. Pra tjetër kush është drejtor menaxhues i kompanisë, tjetër kush është përcaktuar si përfaqësues i punëdhënësit dhe dikush krejt tjetër e ka nënshkruar kontratën përkatëse të punës sipas vërtetimit noterial. Prandaj është gjetur se pretendimi ankimor me numër 9 është pretendim i bazuar.

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot me datë: 05.04.2023 (pesë prill dymijë e njëzet e tre), para Haxhë J Qorraj, Noter në Deçan, rruga "Sali Çeku" Pn. u paraqit:-----

**TERMOMONTIMI SH.P.K.** me numër unik identifikues 810197104, dhe me numer të biznesit 71144410, Prishtinë, , Zona Industriale, të cilen ndërmarrje në bazë të autorizimit me numër LRP.nr. 1436/2023, të datës 03.02.2023, e përfaqëson:-----

**Avni (Jahir) Derguti** lindur me datë 15.07.1985 (pesëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) në Rezallë/Skenderaj ku dhe banon, shtetas i Republikës së Kosovës i cili identifikohet me letërnjoftim me nr. Personal 2030540177 dhe-----

**Xhavit (Misl) Jasiqi** lindur me datë 20.11.1964 (njëzet nëntor njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) në Gramaçel/Deçan ku dhe banon, i cili identifikohet me Letërnjoftim me numër personal 1003522489, të cilët kanë kërkuar nga unë që të vërtetojnë dokumentin i sjellë nga ata i redaktuar jashtë zyrës noteriale si: **KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR**, i cili është përpiluar në katër faqe dhe katër fletë, ku noter i nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e tij vërteton se:-----

Nënshkrimi nga ana e tyre është i vërtetë dhe se e njëjtit këtë **KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR** e kanë nënshkruar me dorën e tyre në prezencën e noterit.-----

Kompensimi i noterit në bazë të nenit 31.2 UA me numer 05/2022 në vlerë prej **09.00€** (nëntë euro) plus 18% TVSH.-----

KY Dokument lëshohet, në Deçan, në bazë të nenit 3. pika 1.2 dhe nenit 48 të ligjit mbi noterinë.-----

NOTER: Haxhë J Qorraj



Sa i përket pretendimit ankimor nr. 10, duhet cekur se ky pretendim ankimor i referohet dosjes së tenderit të formuluar si në vijim:

**F. Një (1) Inxhinier i Inxhinierise mekanike – Drejtimi Komunikacion rrugor**

**F:**

- Diplomë universitare e programit master – Kopje e Noterizuar;
- CV-në e nënshkruar nga kandidati;
- Kontratën e punës të përbërshme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;
- Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës (ne ekzekutimin e projekteve të rrugëve), min. 5 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet me te paktën nje kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara;

Faqe 8 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)



Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se për pozitën në fjalë është caktuar z. Gani Musliu. Për të njëjtin është bashkangjitur edhe kontrata e punës për kohë të pacaktuar (e përhershme). Prandaj pretendimi ankimor është i pazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 12 ku thuhet se *"Inxh Sali Fazliu –IDN-Hidroteknik ka marrëdhënie pune të përhershme me një institucion tjetër"* komisioni përkatës me rastin e rivlerësimit duhet të sqaroj nëse ky informacion i parashtruesit është i saktë ose jo.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 13, duhet cekur se ky pretendim i referohet kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

**A. Inxhinier i ndërtimtarisë-  
Drejtimi konstruktivë-  
Menaxher i projektit**

**A:**  
•Diplomë universitare e programit master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në Kosovë) – Kopje e Noterizuar;  
• CV-në e nënshkruar nga kandidati;  
• Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;  
• Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës, min. 7 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet me të paktën një kontratë të përfunduar me natyrën e kontratës, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara.

Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se për pozitën në fjalë (menaxher i projektit) është caktuar z. Hilmi Mulaku. Për të njëjtin është bashkangjitur një kontratë e punës e nënshkruar me datë 07.01.2015. Në titull të kontratës thuhet se kontrata është lidhur për kohë të pacaktuar. Mirëpo në nenin 6 të kësaj kontrate është përcaktuar si në vijim *"I punësuari themelon marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe atë prej 07.01.2015 me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes mes palëve..."*. Në këtë mënyrë është gjetur se neni 6 është në kundërtënie të plotë me titullin e kontratës së nënshkruar. Prandaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Përndryshe me rastin e rivlerësimit, komisioni për rivlerësim duhet të sqaroj saktësisht nëse kjo kontratë e punës është në përputhje ose jo me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Vlen të shtohet se në CV e z. Hilmi Mulaku nuk figuron fare përvoja e tij e punës por vetëm projektet ku i njëjti ka shërbyer.

Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 14, vlejnjë sqarimet e njëjta sikurse me rastin e shqyrtimit të pretendimit me nr. 13, me dallimin se këto sqarime në këtë rast vlejnjë edhe për z. Milaim Sylka. Pra edhe te inxhinieri i gjeodezisë z. Milaim Sylka është prezantuar kontrata e punës e nënshkruar me datë 07.01.2016 ku në titull të kontratës thuhet se kontrata është me afat të pacaktuar mirëpo në nenin 6 të saj thuhet se *"I punësuari themelon marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe atë prej 07.01.2016 me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes mes palëve..."*. Në këtë mënyrë është gjetur se neni 6 është në kundërtënie të plotë me titullin e kontratës së nënshkruar. Prandaj pretendimi ankimor është pjesërisht

i bazuar. Përndryshe me rastin e rivlerësimit, komisioni për rivlerësim duhet të sqaroj saktësisht nëse kjo kontratë e punës është në përputhje ose jo me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Vlen të shtohet se edhe në CV e z. Milaim Sylka nuk figuron fare se ka punuar ndonjëherë për këtë operator ekonomik.

Lidhur me pretendimin ankimor me nr. 15, duhet cekur se ky pretendim i referohet kërkesës në dosjen e tenderit si në vijim:

**G. Një (1) Teknik – Drejtimi i Ndërtimtarisë**

**G:**

- **Diplomë epo certifikata të trajnimit profesional – Kopje e Noterizuar;**
- **CV-në e nënshkruar nga kandidati;**
- **Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;**
- **Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës, min 3 vjet dëshmuar me te paktën nje referencae origjinale apo të noterizuara;**

Nga kërkesa e dosjes së tenderit shihet se dëshmia e kërkuar dokumentare është alternative pra ose diploma ose certifikata e trajnimit dhe nuk është vetëm diploma e shkollës së mesme sikurse pretendon parashtruesi.

Lidhur me pretendimin ankimor me nr. 16, duhet cekur se ky pretendim i referohet kërkesës në dosjen e tenderit si në vijim:

**3. Te nenshkruset Aneksi 7 i dosjes se tenderit ku OE dëshmonë se i ka ne dispozicion paisje e listuara nga AK te nevojshme per kete projekt.**

**3. Për secilën paisje duhet të jetë dëshmia e pronësisë apo kontrata e marrjes me qira për këtë kontratë. Te gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen regjistrimit duhet të kenë regjistrim me validitet.**

Ndërsa aneksi 7 i dosjes së tenderit është përcaktuar si në vijim:

## **Aneksi 7. Lista e pajisjeve profesional të OE.**

Katër (4) Kamion vetëshkarkues, kapacitet min,10 m<sup>3</sup>

Një (1) Ekskavator

Një (1) Cilindra për ngjeshje të nën bazës

Një (1) Grejder

Një (1) Finisher për shtrirjen e asfaltit

Dy (2) Cilindra për asfaltim

Një (1) Cisternë e ujit

Një (1) Spërkatës për bitumen dhe emulsion

Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se si dëshmi për makineri janë dorëzuar librezat e qarkullimit për kamionët (etj) të cilët janë në pronësi të operatorit ekonomik "HaxhaKom". Mirëpo në ofertë nuk është gjetur si e bashkangjitur edhe marrëveshja për huazimin e kësaj makinerie nga kjo kompani. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 22.01.2024**

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Kompania e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.